

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje kompjuterike”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)- Kompjutera
desktop: 30213300-8, Projektor: 38652100-1**

**VLERA E FONDIT LIMIT I MARRËVESHJES KUADËR: 5,698,880 (pesë milion e gjashtëqind
e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh .**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së*

Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhes të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

a) Certifikatë ISO 9001:2015/ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Bazuar në VKM Nr. 285 date 19.05.2021, neni 44 “Kërkesat e cilësisë” Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së shërbimit që ofron.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **35%** e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 35% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar; nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se **35%** e vlerës së fondit limit te këtij është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përçindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/distributori i autorizuar për tregtimin e artikujve objekt prokurimi (sipas tabelës përmbledhëse). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose broshurë të prodhuesit për mallin që oferton,

-(Në katalog, të markohet në menyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt e kuotuar sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në ftesën për ofertë.

-Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.

Nëse katalogu është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Specifikimet teknike të modelit të kuotuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të kërkuara në ftesën për ofertë për përputhshmërinë e tyre.

Argumentim: Në bazë të pikës 6/b, të nenit të 40 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Nga ana e AK janë kërkuar katalogë në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur duke qenë se nëpërmjet kërkesës për dorëzim e katalogëve AK krijon siguri të plotë dhe vërteton përmbushjen e specifikimeve teknike dhe përputhshmërinë e mallrave të kërkuar me ato të ofertuar nga operatori ekonomik.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.